

Vizitë studimore e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në Poloni

Në datat 7 dhe 8 Korrik 2016, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil zhvilloi një vizitë studimore në Varshavë, Poloni, me ftesë të Kreut të Shërbimit Civil të Republikës së Polonisë, Z. Dobrosław Dowiat-Urbański.



Gjatë kësaj vizite, delegacioni shqiptar, i kryesuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Znj. Pranvera Strakosha, u takua me Kreun e Shërbimit Civil Polak, Z. Dobrosław Dowiat-Urbański dhe drejtues të rëndësishëm në Departamentin e Administratës Publike. Në fjalën e mirëseardhjes, Z. Urbański shprehu kënaqësinë e pjesëmarrjes në këtë vizitë të delegacionit shqiptar dhe njëkohësisht theksoi se Polonia mbështet të gjitha përpjekjet e Shqipërisë për anëtarësimin e saj në Bashkimin Evropian. Nga ana tjetër, Znj. Strakosha theksoi rëndësinë e këtij bashkëpunimi dypalësh të saponisur dhe më tej e njohu Z. Urbański me zhvillimet më të rëndësishme dhe sfidat e shërbimit civil shqiptar.

Në vijim të takimit, delegacioni shqiptar pati mundësi të njihej me historikun dhe kuadrin e përgjithshëm të reformave administrative në Poloni, të drejtat dhe detyrat e trupës së anëtarëve të shërbimit civil, rekrutimin dhe përzgjedhjen në shërbimin civil polak, sistemin e shpërblimeve dhe financimin, etikën profesionale, procedimin disiplinor, rastet nga gjyqësori, standardet dhe mjetet e menaxhimit të burimeve njerëzore, trajnimin dhe zhvillimin profesional, përshkrimet e punës dhe vlerësimin e nëpunësve, si dhe përfundimin e marrëdhënies së punësimit në shërbimin civil.



Delegacioni shqiptar pati mundësi të zhvillonte një takim mjaft frytdhënës edhe me Drejtorin e Shkollës Kombëtare të Administratës në Poloni, Z. Jan Pastwa, i cili foli mbi historikun e krijimit dhe arritjeve 26-vjeçare të kësaj shkolle, rolin e saj në sistemin e shërbimit civil në Poloni dhe trajnimet e nëpunësve publikë.



Kjo vizitë u përmbyll me takimim në ambientet e Ministrisë së Financave, ku përfaqësues të këtij institucioni prezantuan me detaje procesin e rekrutimit dhe sistemin e trajnimit në administratën tatimore dhe doganore në Poloni.